



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačke Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

SHPALLJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e ekspertit për anëtar të Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare

Bazuar në nenin 32, 68 dhe 69 të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenin 8 paragrafin 1, nen paragrafin 1.4. të Udhëzimit Administrativ MPFVLÇ nr. 01/2026 për Procedurën, Dhënie, Përsëritjen, Pezullimin dhe Marrjes së Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.

Fton të interesuarit ekspert me përvojë pune në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, i cili nuk përfaqëson ndonjë organizatë që të aplikojnë përmes procesit të shpalljes publike për tu zgjedhur anëtar në *Komisionin për Shqyrtim dhe Vlerësim të Kërkesave për Licencim të Ofruesve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare*.

Obligimet, përgjegjësitë e Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave për licencim të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe kohëzgjatja e mandatit:

- Komisioni për Shqyrtim dhe Vlerësim, vlerëson dhe analizon dokumentacionin e dorëzuar dhe realizon vizitë në terren për verifikimin e gjendjes faktike, lidhur me plotësimin e kushteve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nga ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare. Përcakton listën e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare që kanë plotësuar kushtet për licencim dhe ia dorëzon Ministrit për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (në tekstin e mëtejshëm: Ministri) për të nxjerr vendim dhe lëshon licencën për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.
- Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të Komisionit është tre (3) vite me mundësi riemërimi edhe për një mandat.

Kriteret për aplikim:

- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, i cili nuk përfaqëson ndonjë organizatë që aplikon për licencim.
- Përparësi kanë kandidatet e diplomuar në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesë për aplikim;
- CV-ja;
- Fotokopja e letërnjoftimit;
- Fotokopja e diplomës (e noterizuar);
- Vërtetimin mbi përvojën e punës (origjinale ose kopje e noterizuar);
- Certifikatën nga gjykata kompetente mbi dënimet penale.

Afati dhe adresa për aplikim:

Paraqitja e kërkesave të përcaktuara do të zgjatë 15 ditë, nga dita e publikimit të kësaj ftesë publike, përkatësisht nga data 01.09.2026 deri më datën 16.09.2026.

Të interesuarit, kërkesën me dokumentet e nevojshme për aplikim mund t'i dërgojnë në pako të mbyllura në arkivin e MPFVLÇ, në adresën Sheshi Mis Edit Durham nr. 46, 10000 Prishtinë.